



Ti dyshohesh për një vepër penale

Si të dyshuar të kanë arrestuar dhe të kanë marrë në komisariat të policisë ose të kanë ftuar për të marrë në pyetje.

Albanees

Je në moshë 12 deri 18 vjeç dhe ke bërë diçka që sipas ligjit nuk lejohet. Si për shembull, shkatërrim, vjedhje apo keqtrajtim. Policia (apo ndonjë shërbim tjetër hetues) të ka ndaluar (arrestuar), të ka shoqëruar në një komisariat të policisë dhe bën hetime. Ose, është kërkuar që të shkosh në një komisariat të policisë, sepse policia dëshiron që të marrë në pyetje. Marrje në pyetje do të thotë se policia dëshiron të bisedojë me ty dhe të bëjë pyetje. Është me rëndësi për ty që të dish se cilat janë të drejtat tua.

Prandaj, lexoje me kujdes këtë tekst. Nëse pas leximit ke ndonjë pyetje, bëja ato avokatit tënd ose zyrtarit të policisë.

Nëse nuk je arrestuar, por policia ka kërkuar që të vish në komisariat e policisë për marrje në pyetje, vazhdo leximin nga pjesa “Kur të nevojitet një avokat?”.

Ty të kanë ndaluar dhe të kanë marrë në një komisariat të policisë.

Cilat janë të drejtat tua?

- Policia ka për detyrë të tregojë se për çfarë dyshohesh.
- Policia të rregullon një avokat.
- Nëse tanimë ke vetë një avokat, këtë mund t’ia komunikosh policisë.

- Policia ia komunikon të dhënat tua (emrin, adresën, datëlindjen etj.) Këshillit për Ndihmë Ligjore [*Raad voor Rechtsbijstand*]. Atëherë, Këshilli e thërret atë avokat për ty.
- Avokati yt punon vetëm për ty dhe nuk është i policisë.

Informacion për prindërit, kujdestarin apo përkujdesuesit

Fëmija juaj dyshohet për një vepër penale. Në këtë fletë informuese mund të lexoni se cilat të drejta i ka fëmija juaj gjatë hetimeve policore. Policia ka për detyrë që t’ju njoftojë se fëmija juaj është arrestuar dhe se qëndron në komisariat e policisë apo se fëmija juaj është ftuar për t’u marrë në pyetje. Përveç kësaj, policia duhet t’ju njoftojë për zhvillimet e mëtejshme të hetimeve. Konsultohuni me policinë për marrje në telefon ose për të vizituar fëmijën tuaj.

Për më tepër informacione

Vizitoheni për më tepër informacione faqen e internetit juridischloket.nl ose merrni numrin 0900 – 8020 (0,10 € për minutë). Nga e hëna deri të premten në mes orës 09.00 dhe 17.00.

- Ti do të kesh një bisedë me një **ndihmës të prokurorit**, që është një lloj drejtuesi në polici. Kjo bisedë mund të bëhet po ashtu përmes telefonit ose përmes një telefonate video dhe këtë e quajmë **nxjerrje para prokurorit**. Ndhmës prokurori do të tregojë se cilat janë të drejtat tua dhe po ashtu mund të bëjë pyetje. Nuk ke detyrim që t'u përgjigjesh pyetjeve. Megjithatë lejohet të përgjigjesh. Ti ke të drejtë që të heshtësh. Kjo quhet **e drejta e heshtjes**. Po ashtu, ndihmës prokurori do të tregojë se çfarë mund të ndodhë në vazhdim dhe vendos nëse tani për tani duhet të mbetesh në komisariat të policisë apo jo.
- Një mjek, ose dikush që punon për një mjek, mund të kontrollojë nëse je mjaft mirë me shëndet për t'iu nënshtruar një marrjeje në pyetje apo ndonjë hetimi tjetër policor. Nëse ekziston arsye për këtë, policia, avokati yt ose prindërit (kujdestari ose përkujdesuesit) tu ose ti vetë mund të kërkojnë mjek. Mjeku mund të caktojë që policia të presë pak para se të marrë në pyetje apo të bëjë ndonjë tjetër hetim policor. Ekzaminim i mjekut është falas.
- Nëse holandishten nuk e flet apo kupton aspak apo jo mirë, atëherë ke të drejtë që të asistohesh nga një përkthyes (interpret). Përkthyesi është falas. Ti keni të drejtë që t'i lexosh **aktet procedurale** (ato që policia i ka shkruar lidhur me çështjen tënde). Avokati yt mund t'ia kërkojë prokurorit aktet tua procedurale.
- Nëse ti nuk e kupton aspak ose jo mirë holandishten, ke të drejtë që pjesët e rëndësishme të dosjes tënde t'i lexosh në gjuhën tënde, në mënyrë që ato t'i kuptosh.

Çfarë do të ndodhë tjetër?

- Policia duhet t'u tregojë prindërve (kujdestarit ose përkujdesuesve) tu se ndodhesh në polici dhe se tani për tani do të mbetesh aty. Nëse nuk ke prindër (kujdestarë ose përkujdesues), ose nuk janë të qasshëm, atëherë policia do të pyes se cilin person të rritur mund ta kontaktojnë. Nëse nuk ke një të tillë, atëherë policia kontakton me Këshillin për Mbrojtje të Fëmijëve [*Raad voor de Kinderbescherming*].
- Këshilli për Mbrojtje të Fëmijëve është organizata që shqyrton se çfarë dënimi dhe/ose ndihme mund të jetë i/e përshtatshëm(me) për ty. Këshilli e shikon situatën tënde, çfarë ke bërë dhe sa janë të rënda ato që i ke bërë.
- Prindërve tu (kujdestarit ose përkujdesuesve) u lejohet që ty të marrin në telefon dhe të vizitojnë në komisariat të policisë.
- Nëse nuk jeton në Holandë, mund të kërkojnë nga policia që të kontaktojnë me ambasadën e vendit tënd.

Qëndrimi në polici

- Nëse dyshohesh për një vepër të lehtë, si p.sh. fyerje, policia mund të mbajë në komisariat të policisë maksimumi gjashtë orë. Në ato orë nuk llogariten orët e natës (nga ora 00.00 deri në ora 09.00). Pas, maksimumi gjashtë orë, policia duhet të të lirojë.
- Nëse dyshohesh për një vepër të rëndë penale, si p.sh. shkatërrim, vjedhje apo keqtrajtim, atëherë policia mund të mbajë në komisariat të policisë maksimumi nëntë orë. Edhe në këto orë nuk llogariten orët e natës (nga ora 00.00 deri në ora 09.00). Sapo të kalojnë ato nëntë orë, mund të vendoset që të qëndrosh kohë më të gjatë. Në rast të tillë, policia mund të mbajë maksimumi edhe tre ditë të tjera në komisariat të policisë. Ndonjëherë, kjo mund të zgjatet edhe me maksimumi tre ditë të tjera. Pra, në rastin më të keq, në komisariat të policisë mund të mbajnë gjashtë ditë. Këtë e quajmë **paraburgim**.
- Nëse je arrestuar në mbrëmje, policia mund të vendosë që ta shtyjë marrjen në pyetje. Në atë rast, policia cakton me ty dhe me prindërit (ose kujdestarin apo përkujdesuesit) tu një takim për të ardhur të nesërmen në komisariat të policisë. Do të lejohet që në ndërkohë të shkosh në shtëpi, mirëpo të nesërmen duhet të kthehesh.
- Në rast paraburgimi ndonjëherë të lejohet që të flesh diku tjetër, si në shtëpi, për shembull. Por gjatë ditës duhet të jesh në komisariat të policisë. Policia dhe prokurori vendosin për këtë.
- Në qoftë se prokurori mendon se pas paraburgimit duhet të qëndrosh kohë më të gjatë i mbyllur, për atë vendos gjyqtari. Në rast të tillë, shpeshherë të transferojnë në një institut burgimi për të mitur dhe atëherë nuk qëndron më në komisariat të policisë.
- Pyete avokatin tënd se çfarë mund të bësh po qe se nuk pajtohesh me ndalimin tënd apo me vendimin që të mbajnë më gjatë të mbyllur.
- Nga çasti kur nuk është më e nevojshme që të qëndrosh në polici, ti duhet të lirohesh.

Kur të nevojitet një avokat?

- Nëse të merr në pyetje policia, atëherë policia kujdeset që ty të caktohet një avokat. Avokati është për ty dhe mund të bëjë diçka vetëm nëse për atë ka biseduar me ty. Avokati ka po ashtu për detyrim ruajtjen e sekretit. Të gjitha ato që ju ti ia tregon avokatit, mbeten mes teje dhe atij apo asaj. Avokatit nuk i lejohet që t'i tregojë dikujt diçka pa pëlqimin tënd.
- Nëse je arrestuar, ke vetë një avokat në mendje dhe dëshiron që të vijë ai avokat, këtë duhet t'ia komunikosh policisë. Atëherë policia do ta kontaktojë atë për ty.

- Nëse je ftuar për t'u marrë në pyetje, do të rregullohet po ashtu një avokat për ty. Në letrën e ftesës që policia të ka dërguar në shtëpi shkruan se çfarë duhet të bësh nëse vetë njeh ndonjë avokat.
- Në të shumtën e rasteve avokati është falas. Policia do të tregojë në rast se nuk është falas.

Marrje në pyetje: bisedë me policinë

- Policia do të bisedojë me ty dhe ka të drejtë që të bëjë pyetje.

Para marrjes në pyetje

- Nëse je arrestuar, do të vijë sa më shpejt që të jetë e mundur një avokat për të dhënë këshilla. Policia mund të të marrë në pyetje vetëm pasi të kesh biseduar me një avokat. Do të nevojitet pak kohë deri sa avokati të arrijë në komisaratin e policisë. Kjo mund të zgjasë rreth dy orë.
- Nëse je arrestuar, më parë do të flasësh me avokatin tënd për atë se çfarë ka ndodhur dhe çfarë mund të presësh. Me avokatin do të flasësh rreth gjysmë ore. Nëse nevojitet më tepër kohë, kjo bëhet e mundshme.
- Policia nuk dëgjon kur ti bisedon me avokatin tënd.
- Nëse ke nevojë, gjatë asaj bisede do të asistojë një përkthyes. Pas përfundimit të bisedës me avokatin, përkthyesit nuk i lejohet t'i tregojë asgjë policisë lidhur me atë bisedë.
- Në qoftë se policia të ka ftuar për të marrë në pyetje, atëherë, para se të vizitosh komisaratin e policisë duhet të kesh biseduar me një avokat. Avokati e di se në sa ora fillon marrja në pyetje dhe kujdeset që të jetë i pranishëm në kohë.
- Avokati të tregon se si zhvillohet marrja në pyetje dhe këshillohet me ty se si mund të veprosh më së miri apo çfarë t'i thuash policisë. Po ashtu, avokati mund të kontaktojë me familjen tënde, shefin e punës tënde ose vendin ku je duke bërë praktikën e shkollës për t'u treguar se je në polici. Avokati i bën këto vetëm me pëlqimin tënd.

Gjatë marrjes në pyetje

- Fillon biseda me policinë. Ata mund të pyesin.
- Ti nuk ke detyrim që t'u përgjigjesh pyetjeve të policisë (por lejohet). Ti ke të drejtë që të heshtësh.
- Nëse nuk e kupton zyrtarin e policisë, këtë lirisht mund ta thuash. Pastaj zyrtari i policisë duhet të ta shpjegojë më mirë, me fjalë të tjera, pyetjen.
- Nëse ke nevojë, gjatë marrjes në pyetje do të asistojë një përkthyes.

Avokati gjatë marrjes në pyetje

Avokati rri ulur pranë teje në dhomën për marrje në pyetje dhe e ka të lejuar që:

- të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje;
- të bëjë vërejtje në fillim dhe në fund të marrjes në pyetje;
- t'i bëjë pyetje policisë;
- të pyes ty nëse e kupton se çfarë thuhet;
- të kujdeset që mos të detyrojnë të thuash diçka;
- të kujdeset që mos të kesh frikë nga policia;
- të kërkojë që marrja në pyetje të ndërpritet pak. Atëherë avokati mund të flasë vetëm me ty. Edhe vetë mund të kërkosësh që të flasësh vetëm me avokatin tënd. Nëse kërkon shpesh një gjë të tillë, policia mund të thotë "jo".

Filmimi ose regjistrimi i marrjes në pyetje

- Policia ndonjëherë ka për detyrë që marrjen në pyetje ta regjistrojë me kamera dhe/ose mikrofon. Për shembull, nëse bëhet fjalë për vepra të rënda penale kur dikush është plagosur rëndë. Për këtë janë caktuar rregulla. Nëse policia bën regjistrim filmi apo zonor, policia këtë duhet të ta thotë që në fillim të marrjes në pyetje.

Prania e një personi të besueshëm në marrje në pyetje

- Kur do të të marrë policia në pyetje, lejohet që gjatë asaj marrje në pyetje të jetë i pranishëm edhe një person i besueshëm për ty (**një person i besueshëm**). Ai person mund të jetë babai yt apo nëna jote ose një tjetër person irritur. Nëse dëshiron një gjë të tillë, duhet që këtë t'ia thuash avokatit dhe policisë. Nuk është e detyrueshme që të kërkohet një person i besueshëm gjatë marrjes në pyetje.
- Personi i besueshëm ka të drejtë vetëm të dëgjojë. Ai ose ajo ka të drejtë që të ulet afër teje, por vetë nuk ka të drejtë të thotë asgjë. Personi i besueshëm duhet të jetë i moshës mbi 18 vjeç dhe duhet që mos të jetë i/e përfshirë në veprën penale për të cilën dyshohesh ti.
- Ndonjëherë policia mund të refuzojë që në marrje në pyetje të jetë i pranishëm një person i besueshëm. Në atë rast, policia duhet ta pyesë prokurorin se a pajtohet ai me këtë apo jo.

Raporti

- Nga marrja në pyetje hartohet një raport. Ky raport quhet **procesverbal**. Ky është një raport i rëndësishëm ku është shkruar se çfarë i ke thënë policisë gjatë marrjes në pyetje. Pra, ky është rrëfimi yt për atë se çfarë ka ndodhur.
- Pastaj, prokurori e ndonjëherë edhe një gjyqtar i lexojnë ato që i ke treguar. Prandaj, është e rëndësishme që t'i lexosh mirë ato që janë shkruar. Nëse nuk mund të lexosh mirë, kërko nga policia që ato t'i lexojnë për ty.

- Nëse je dakord me ato që janë shkruar, policia kërkon që ta shkruash emrin tënd dhe të firmosësh në fund. Nëse mendon se nuk janë shkruar mirë, kërko nga policia nëse ato mund t'i ndryshojë. Edhe avokati mund të verifikojë nëse policia i ka shkruar mirë fjalët tua dhe të ndihmojë për këtë.

Pas marrjes në pyetje

- Pas përfundimit të marrjes në pyetje dhe nëse nuk është më e nevojshme që të mbajnë më gjatë në komisariat të policisë, do të lejohet të shkosh në shtëpi. Ndonjëherë duhet të presësh edhe pak, kur policia dëshiron të bëjë edhe disa pyetje. Nëse duhet të qëndrosh, policia do të tregojë se çfarë do të ndodhë në vazhdim. Ndonjëherë mund të pasojë edhe një marrje tjetër në pyetje.
- Nëse duhet të qëndrosh, do të vizitohë po ashtu një punonjës i Këshillit për Mbrojtje të Fëmijëve. Ai ose ajo e shikon se si je dhe nëse ke nevojë për ndihmë. Këshilli për Mbrojtje të Fëmijëve e hulumton situatën tënde dhe e këshillon prokurorin ose gjyqtarin për atë se cili dënim (apo cila ndihmë) është më i/e përshtatshëm për ty.
- Prokurori vendos nëse do të lirohesh apo do të mbajnë edhe më gjatë mbyllur. Nëse duhet të mbajnë më shumë se tre ditë dhe kjo eventualisht të zgjatet me tre ditë të tjera (**paraburgim**), në atë rast duhet të vendosë gjyqtari për të mitur. Kjo bëhet pavarësisht nga qëndrimi yt në komisariat të policisë.
- Për vendimin e prokurorit policia do të njoftojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Ndonjëherë ky vendim nuk të komunikohet menjëherë dhe mund zgjatë pak.
- Nëse je arrestuar dhe të lejohet që të shkosh në shtëpi, atëherë policia e thërret prindin tënd (ose kujdestarin apo përkujdesuesit) që të vijnë për të marrë.

Shënim i botuesit Këtë dokument e ka hartuar:

Ministria e Drejtësisë dhe Sigurimit
Postbus 20301 | 2500 EH | Den Haag

maj 2022 | 22403201

Në sajë të kësaj flete informuese nuk mund të rrjedhë asnjë e drejtë.

